

Diaspora

Zvicër: Tel. +41 (0) 79 705 19 00 · E-Mail: diaspora@zerionline.info

Gjermani: Tel. +49 (0) 7331 30 18 19 · Fax: +49 (0) 7331 30 18 96 · E-mail: diaspora@zeridites.de

di@-logu

Çfarë presim nga diplomatët tanë?

Kosova së shpejti do t'i ketë përfaqësitë e saj diplomatike në disa vende të botës. Në mesin e tyre, edhe në vendet e Evropës Perëndimore, ku numri i shqiptarëve është mjaft i madh, si në Gjermani, Zvicër, Itali, Belgjikë, Austri etj. Çka presin bashkatdhetarët tanë nga përfaqësitë diplomatike të Kosovës dhe çfarë prioritesh do t'u rekomandoni ata diplomatëve kosovarë, për punën që i pret në raport me mërgatën tonë në këto vende. Për këto mund të na shkruani në adresën e përhershme: diaspora@zerionline.info

www.zeridites.de

Intervistë me Blerim Destanin, aktor kryesor dhe producent i filmit "Koha e kometës"

"Koha e kometës" - një ëndërr e realizuar

Pas vlerësimit si "filmi më i mirë shqiptar" në Festivalin Veror Ndërkombëtar të Filmit, që u mbajt në Durrës, filmi i regjisorit Fatmir Koci, kohë më parë është shfaqur në Prishtinë, Tiranë dhe Tetovë. Ky film është një ndër projektet më të shtrenjta kinematografikë të bërë ndonjëherë nga shqiptarët. Në këtë projekt llogaritet që janë investuar rreth dy milion euro. Për promovimin e filmit, aktrimin dhe çështjeve të tjera flasim me aktorin kryesor dhe producentin Blerim Destanin, i cili jeton prej kohësh në Gjermani

Intervistoi: Elife Kurteshi

Zëri: Tani u bë një vit nga përfundimi i xhirimit të filmit "Koha e Kometës". Gjatë kësaj kohë filmi kishte kontakt me një pjesë të kritikës. Çfarë janë vlerësimet e para që keni pranuar nga tyre?

Blerim Destani: Vlerësimet për filmin janë shumë pozitive, që në prezantimin e parë në Berlin ku u prezantua varianti para-final i filmit ashtu edhe varianti final. Si reagimet e kolegëve ashtu edhe ato të publikut ishin shumë pozitive, pasi vërtetë filmi komunikoi me të gjithë. Kjo më gëzoi shumë pasi filmi tani po vazhdon jetën e vet duke komunikuar me publikun e vet. Unë në përgjithësi jam njeri pozitiv dhe reagimet pozitive më mbushin me energji për të vazhduar edhe më tej.

Zëri: Filmi, pak kohë më parë është promovuar në Tetovë, Tiranë dhe Prishtinë. Si e ndjeni vetën pas promovimit të suksesshëm?

Blerim Destani: Ndjem përplot me energji dhe emocione. Gjatë kohës kur po xhironim filmin, përherë diku në kokë na qëndronte pezull pyetja se: vallë si do të reagojë publiku kur t'i shohë skenat që po i xhironim? Përherë ishim në mes të asaj se si ndjeheshim ne dhe se si do të perceptohet e gjithë ajo nga publiku. Gjatë promovimit të filmit në Durrës, Prishtinë dhe

Tetovë, të gjitha pyetjet që i kisha në kokë, u zhdukën. U zhdukën pasi vetë e përjetova se publiku reagonte aq natyrshëm dhe emocionalisht. Kjo më bëri krenar për gjithë mundin dhe energjinë që kemi investuar në "Koha e kometës". Rruga jetësore e Shehanit (roli që interpretoj unë) dhe çetës (Alushi, Doska, Todi dhe Cutja) ashtu si edhe e Anjezës dhe Kus Babait, ndiqej dhe përjetohej thellë nga publiku. Për mua kjo ishte e rëndësishme, pasi mund të thuhet që unë isha aktori me më pak përvojë nga kolegët që interpretonin. Mu për këtë edhe mu desh që të përgatitem gjatë dhe të punoj me një përkushtim që vet roli e kërkonte nga unë. Dhe nuk ka kënaqësi më të madhe kur sheh se e gjithë ajo energji dhe emocionet që janë investuar në film, komunikojnë me publikun dhe ngjallin tek ata reagime shumë emocionale.

Vlerësimi nga publiku dhe kritika më tregojnë se jam në rrugë të drejtë...

Zëri: Sukses mund të quhet edhe marrja e trofeut "fitues i



Blerim Destani

filmit më të mirë kombëtar" në festivalin e Durrësit. Çka do të thotë ky shpërblim për stafin realizues dhe në veçanti për ju personalisht, por edhe për ju si aktor?

Blerim Destani: Çmimi "Filmi më i mirë shqiptar" në festivalin e Durrësit ishte një mirënjohje e madhe për të gjithë ekipin e filmit që ka punuar me shumë përkushtim në realizim e "Koha e kometës". Ndërsa për mua në veçanti edhe si aktor por edhe si producent i filmit, ishte një kënaqësi e veçantë. Kjo ndjenjë e kënaqësisë është shumë domethënëse pasi e sheh se si një angazhim i yti dhe një mund të investuar has në vlerësimin e jurisë profesionale, pra e sheh se gjithçka që ke investuar disi ka zënë vendin e vet. Kjo më shton motivimin që të vazhdoj më tej, pasi jam në rrugë të drejtë.

Zëri: Gjatë festivalit kritika për këtë projekt nuk ka qenë edhe aq pozitive, me gjithë faktin se realizimi ka kushtuar 2 milion euro. Pra, në historinë e kinematografisë shqiptare "Koha e kometës" është filmi më i shtrenjtë. A besoni që ia ka vlejtur?

Blerim Destani: Nuk jam dakord me ju se filmi ka pasur "kritik jo dhe aq pozitive"! Përkundrazi, filmi përjetoj vlerësime të lakmueshme. Ishte vetëm një deklaratë e kolegut Çun Lajçi që u keqkuptua nga gazetarët. Çuni shprehu dëshirën e tij që premiera të ishte në Tiranë, ku do të kishte më shumë "publik profesional", ku do të kishte më shumë kolegë nga sfera e kinematografisë, pasi disa nga emrat më të spikatur nuk ishin në festival. Kjo deklaratë e tij është keqkuptuar. Ajo që mundem të them është se filmi ka përjetuar vlerësime të larta nga kritika. Ndërsa ajo që ndodhi në Prishtinë

është treguesi më i qartë se filmi i ka thyer të gjitha rekordet e shikueshmërisë në Prishtinë dhe ka kërkesa që të shfaqet edhe në të gjitha qytetet e Kosovës, aty ku ka kushte minimale që filmi të shfaqet konform standardeve. E njëjta gjë ndodhi edhe në Tetovë, filmi u shfaq një javë resht dhe u ndoq me shumë interes. Edhe nga qytetet tona në Maqedoni ka kërkesa që filmi të shfaqet edhe atje. Dhe së shpejti mendoj se duhet t'i përgjigjemi kësaj kërkesë të vet publikut. Ndërsa sa i përket buxhetit të filmit, të gjithë e dimë se filmi në përgjithësi është gjë shumë e shtrenjtë. Veçanërisht nëse dëshiron të jesh në suazat e normave dhe standardeve bashkëkohore të kinematografisë. Kompania ime "LARA Enterprises" është e vetëdijshme për këto kushte dhe standarde, prandaj edhe bëmë gjithçka që ishte e nevojshme që filmi "Koha e kometës" t'i ketë të gjithë parametrat e një filmi bashkëkohor në të gjitha fazat e krijimit të tij. Si në pre-produksion, në produksion ashtu edhe në post-produksion. Pas përfundimit të filmit dhe vlerësimeve që vet filmi po i vjel, si nga kritika ashtu edhe nga publiku, dëshmohej se gjithçka që është investuar në këtë film, ia ka vlejtur.

Jo ndarje në baza fetare!

Zëri: Filmi paraqet edhe ndarjen e shqiptarëve në baza fetare dhe kjo gjë shprehet në momentin kur dy personazhet kryesorë hasin në pengesa për t'u martuar sepse njëri i përket fesë myslimane dhe tjetri katolike. Çfarë mendoni ju personalisht për këtë gjë?

Blerim Destani: Jo. Filmi nuk paraqet ndarjen e shqiptarëve në baza fetare, por paraqet rrezikshmërinë e një ndarje të tillë të mundshme. Ajo do të ishte një çmenduri e vërtetë, siç thotë njëri nga personazhet. Ky është një nga misionet e artit, që të paralajmërojë për mundësi të tilla. Një nga mesazhet kryesorë të filmit është se ndarjet e tilla do të zhdukni dashurinë në përgjithësi. Nëse e keni vërejtur, që në çastin kur çeta niset për të kërkuar luftën, bëhet ndarja e tyre në bazë fetare në krahun e hoxhës dhe të priftit, për ta marrë bekimin e tyre, këtë gjë nuk e bën vetëm Shehani. Ai qëndron i veçuar dhe në mes të dy grupeve. Në fillim të filmit, Shehani e ka vetëm si ndjenjë intuitive se nuk duhet të pranojë një ndarje të tillë, pasi misioni që kanë nisur ta përmushin është kombëtar dhe jo fetar.

Çfarë fshihet prapa emrit "LARA"

Blerim Destani: Kompania "Lara" është një kompani me aktorë të huaj. Biznesi i saj është që ajo përfitojë nga aktorët përmes ndërmjetësimit të tyre ("shitjes") si dhe të realizojë programe televizive. Menaxheri i përgjithshëm është Alain Midzic, menaxher i njohur gjerman me prejardhje boshnjake. Emri LARA për mua ka domethënie personale. Nga dashuria për mbesën time e cila e mban këtë emër, ia kam vënë edhe kompanisë që të ma kujtojë çdo ditë vogëlushen time.

Kjo ndjenjë e tij që po e quaj intuitive në fund të filmit edhe kurorëzohet me dashurinë e tij ndaj Anjezës, e cila është e fesë katolike. Ai e ndjek realizimin e dashurisë e tij, duke i thënë Anjezës se "ka vetëm një Zot". Këto janë edhe gjërat që më kanë pëlqyer më së shumti në leximin e parë të skenarit. Pasi që edhe unë ndjem dhe mendoj ashtu.

Zëri: Ju lutem na tregoni më shumë për rolin e Shehanit. Thoni që keni shumë ngjashmëri me Shehanin. Mundësisht e shpjegoni këtë me gjerësi. Ku e shihni ngjashmërinë?

Blerim Destani: Sapo thashë disa nga gjërat në të cilat kemi ngjashmëri. Pastaj Shehani është një djalë i ri që në momentin e duhur din se si ta lexojë simbolikën e paraqitjes së Kometës. Atë e kupton si Thirrje të fatit. Ai edhe i përgjigjet kësaj thirrjeje. Me këtë përgjigje të tij ai edhe përnjëherë ndryshon gjithçka në jetën e tij. Në të njëjtën kohë ai vërteton se ka kapacitet për të bërë diçka më shumë se ajo çka ka bërë dhe çka mund të bëjë në fshatin ku jeton. Dhe e dëshmon se ka kapacitet për vepra më të mëdha. Si dhe shumë e shumë gjëra tjera... pastaj jam beqar si ai, dhe ende pres që të më paraqitet ndonjë thirrje e tillë e fatit.

Zëri: Si e ndjetë veten gjatë promovimit të filmit në vendlindjen tuaj, në Tetovë?

Blerim Destani: Isha shumë i emocionuar. E ndoqa filmin me frymëmarrjen e përbashkët me publikun. Më është realizuar një ëndërr e fëmijërisë, që në vendlindjen time ta promovoj një film. Ajo që më bëri shumë përshtypje, ishte fakti se të gjithë e vërejtën ecjen time në karrierë, të gjithë më përgëzonin për filmin, duke e krahasuar me rolet e mia të mëparshme. Më befaso i këndshëm se sa i mbanin mend të dy rolet e mia të mëparshme dhe tani e vlerësuan dallimin në prezencën time dhe në lojën time gjatë interpretimit të Shehanit. Vërejtja se ashtu siç janë të radhitur tek unë dy rolet e mia të mëparshme, ashtu ishin të radhitur edhe tek shumica e atyre që e kanë parë filmin. Kjo më ngjalli emocione të fuqishme, pasi aty kam kaluar fëmijërinë time, aty kam shokët e fëmijërisë, si dhe kuptohet miqtë e shumë të familjes sime.



Blerim Destani dhe Marsiela Lusha, dy aktorët kryesorë, në një skenë të filmit "Koha e kometës"